

VENDIM
Nr. 83, datë 20.4.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “VOKOPOLA ENERGIJ” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGIJISË ELEKTRIKE NGA HEC “VOKOPOLA 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 274 kw, “VOKOPOLA 2”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 3104 kw, DHE “VOKOPOLA 3”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2297 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 5675 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 562/7 prot., datë 15.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Vokopola Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Vokopola 1’, me kapacitet të instaluar 274 kw, ‘Vokopola 2’, me kapacitet të instaluar 3104 kw dhe ‘Vokopola 3’, me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Vokopola Energji” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 471 prot., datë 6.4.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Vokopola 1”, “Vokopola 2” dhe “Vokopola 3”, me vendndodhje në lumin e Vokopolës.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe lejet nga institucionet respektive. Sa rezulton nga ky aplikim, shoqëria ka përcjellë dokumentacionin, si vijon:

- Formatin dhe dokumentacionin për aplikim, neni 9, pika 1, gerrat: “a”, “b” dhe “c”, plotësuar;

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, gerrat “a” dhe “b”, plotësuar;

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “d”, plotësuar;

- Dokumentacionin teknik për HEC, neni 9, pika 4.1.3, gerrat: “a”, “b”, “c” dhe “d”, pika 4.1.4, gerrat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, plotësuar;

- Lejen nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, gerrat “a” dhe “c”, plotësuar.

Në lidhje me dokumentacionin e munguar, që ka të bëjë me:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor:

Neni 9, pika 2:

- germa “c” (vërtetimi për regjistrim dhe ekstrakt historik nga Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE edhe certifikatën e regjistrimit pranë QKB-së, si dhe

ekstraktin historik të vulosur nga QKB-ja, jo më herët se 1 muaj nga paraqitja e aplikimit në zbatim të nenit 8, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pasi ekstrakti i depozituar nga shoqëria është jashtë këtij afati. Po ashtu, nga ekstrakti historik i regjistrit tregtar të shoqërisë rezulton se është bërë transferimi i kuotave të një të tretë, pas miratimit të kontratës së koncesionit, ndaj shoqëria duhet të depozitojë informacion, në lidhje me zbatimin e parashikimeve të nenit 17.1, të kontratës së koncesionit të lidhur me METE-n (Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energetikës (sot MIE));

- germa “d” (vërtetim që shoqëria dhe drejtuesit kryesorë të saj, në rastin e personave juridikë, nuk janë të përfshirë në një proces penal të filluar nga organet e drejtësisë (vërtetim nga prokuroria dhe gjykata). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet e prokurorisë dhe gjykatës së rrethit Tiranë, për administratorin dhe vetë shoqërinë;

- germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse. Në rastin e aplikimeve për licencë prodhimi të energjisë elektrike kërkohet paraqitja e licencës për drejtues teknik elektrik).

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit dhe licencën për drejtuesin teknik;

- germa “f” (marrëveshje koncesioni apo çdo formë tjetër e marrëveshjes në rastet e aplikueshme, të lidhur me institucionet përgjegjëse të ngarkuara me ligj, në përputhje me kuadrin ligjor përkatës si dhe ndryshim të këtyre akteve). Shoqëria ka depozituar në ERE kontratën shtesë të koncesionit nr. 784 rep., nr. 310 kol., datë 9.6.2020, ndërmjet MIE-s, në cilësinë e autoritetit kontraktues dhe shoqërisë “Vokopola Energji” sh.p.k., në këtë kontratë referohet dhe një kontratë shtesë koncesioni nr. 110 rep., nr. 31/3 kol., datë 17.1.2019, nënshkruar mes MIE-s dhe shoqërisë koncesionare “Vokopola Energji”, e cila do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë në ERE;

- germa “g” (dokumente që vërtetojnë pronësinë e aplikuesit në zonat ku do të shtrihet projekti (certifikata pronësie, kontrata shitblerje, kontrata qiramarrje, akte dhurimi, kontrata premtim shitblerje, marrëveshje me subjekte private ose shtetërore që kanë në pronësi zonat ku shtrihet projekti për ato veprimtari që përdorin asete të paluajtshme, etj.).

Në kuadër të dokumentacionit të pronësisë, konstatohet se dy prej kontratave të depozituara i ka kaluar afati i vlefshmërisë, ndaj duhet të depozitohen me afate të rinovuara, ndërsa për një të kontratë duhet sqaruar nëse është nënshkruar për një periudhë 2- apo 5-vjeçare, duke i bashkëlidhur dhe të dhënat respektive. Nëse dokumentacioni i pronësisë është i regjistruar në ZVRPP-në përkatëse, shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokumentacion në ERE;

Dokumentacionin financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3:

- germa “a” (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore (për shoqëritë e sapo krijuara vërtetim që nuk ka detyrime)), plotësuar.

Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimet përkatëse;

- germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit/ose të kohës së ekzistencës së shoqërisë (për shoqëritë me ortakë shoqëri të tjera, paraqitja e bilancit të këtyre të fundit)). Shoqëria duhet të depozitojë bilancet financiare të vitit 2021. Po ashtu, duke qenë se nga ekstrakti historik rezulton se shoqëria ka ortakë shoqëri të tjera, duhet të përcjellë dhe bilancin e tri viteve të fundit për shoqëritë ortakë;

- germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit, ku shprehen qartë vlerat monetare për financim dhe struktura e financimit (financim i vetë aplikuesit, kredi bankare, donacione, të tjera)). Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare;

Dokumentacionin teknik për HEC:

- Neni 9, pika 4.1.1 (të dhëna teknike për HEC). Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat në lidhje me rendimentin dhe, duke qenë se ka deklaruar se viti i ndërtimit do të jetë viti 2021 dhe data e fillimit të operimit viti 2022, do t'i kërkohej informacion në lidhje me fazën në të cilën ndodhen punimet e veprës;

- Neni 9, pika 4.1.2 (të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjes me sistemin). Shoqëria duhet të plotësojë të dhënat në lidhje me prodhuesin e transformatorit, kapacitetin, tensionin e përshtjellave dhe kapacitetin transmetues.

Leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5:

- germa "b" (leja e shfrytëzimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike). Konstatohet se shoqëria nuk ka përcjellë lejen për përdorimin e burimit ujq përkatës për HEC "Vokopola 1", të cilën duhet ta depozitojë në vijim. Po ashtu, në vendimin nr. 2/2020, të Këshillit të Basenit Ujq (KBU) Seman është dhënë miratimi i lejes për përdorimin e burimit ujq për prodhim energjie nga HEC "Vokopola 2", ndërkohë që referuar raportit të opjonencës teknike të AKBN-së, të dhënat në këtë leje përkojnë me HEC "Vokopola 3". Po ashtu, në vendimin nr. 3/2020, të KBU Seman është dhënë miratimi i lejes për përdorimin e burimit ujq për prodhim energjie nga HEC "Vokopola 3", ndërkohë që referuar raportit të opjonencës teknike të AKBN-së, të dhënat në këtë leje përkojnë me HEC "Vokopola 2". Në këto rrethana, shoqëria duhet të bëjë saktësimin/sqarimin përkatës.

- Kontrata e koncesionit e formës BOT nr. 7 rep., nr. 3 kol., datë 10.1.2013, për ndërtimin e hidrocentraleve "Vokopola 1", "Vokopola 2" dhe "Vokopola 3", e ndryshuar, ka një afat 35-vjeçar, por nga ana tjetër, ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit, rezulton se shoqërisë i kanë kaluar 9 vjet e 3 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 25 vjet e 9 muaj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Vokopola Energji" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Vokopola 1", me kapacitet të instaluar 274 kw, "Vokopola 2", me kapacitet të instaluar 3104 kw, dhe "Vokopola 3", me kapacitet të instaluar 2297 kw, me kapacitet total të instaluar 5675 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

